Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**29.08.2023**	**11.09.2023**	**2023/0612**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.08.2023, **OE "S.V. Veterina"**- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0612, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime te Dezinfektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit ne objektet Policore."** me nr. të prokurimit: **"214-22-5200-2-1-1",** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë publike kornizë, me një operator ekonomik shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **379,614.27 €**.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0283 i dt: 24.07.2023.

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....10.06.2022;

Procesverbali i hapjes së ofertave.....15.02.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....28.04.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 03.05.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....11.05.2023;

Ankesa ne OSHP.....22.05.2023;

Vendimi i OSHP-se ne ankese 2023/283.....24.07.2023;

Njoftimi mbi vendimin e AK-së.....10.08.2023;

Kërkesa për rishqyrtim 15.08.2023;

Vendimi i AK-së në kërkesë për rishqyrtim.....15.08.2023;

Ankesa ne OSHP.....24.08.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-se

Neni 2 i LPP-se

Neni 6 i LPP-se

Neni 7 i LPP-se

Neni 24 par. 2 dhe 3 te LPP-se

Neni 52 par. 3 dhe 7 te LPP-se

Neni 59 Par. 2 dhe 4 te LPP-se

Neni 6 par. 1 pika 1.1 te LPP-se

Neni 62 i LPP-se

Neni 66 i LPP-se

Neni 67 i LPP-se

Neni 72 i LPP-se

Neni 39.8 i RRUOPP-se Neni 41 i RRUOPP-se

Neni 47.19 i RRUOPP-se

AK - ZPP ka shkelur Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 i dates 24.07.2023

AK - ZPP ka shkelur nenin 13, 47. 48, dhe 52 te Ligjit Nr. 05/L - 031 per Proceduren e pergjitheshem Admnistrative

AK – **POLICIA E KOSOVËS ,** me date 10.08.2023, përmes platformës elektronike eprokurim ka

publikuar njoftimin mbi vendimin e AK (B58), duke shkelur dispozitat ligjor të LPP-së, ku do te shtjellojmë si ne vijim te kësaj deklarate me fakte dhe argumente!

Pretendimet ankimore nga GOE: S.V. "Veterina" &N.N.P. "WENDA" si pale me interes sipas nenin 4 par. 1.26 te LPP-se, lidhur me argumentet dhe faktet e shkeljeve te dispozitave ligjore te LPP-së nga AK, si ne vijim:

AK me datën 24.07.2023 ka pranuar Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 ku është pranuar ankesa jone si e bazuar dhe është obliguar AK te na kërkoj sqarime ne pajtim me nenin 72 te LPP-se, dhe nga ajo date kur AK ka pranuar vendimin e OSHP ne fjale nuk na është drejtuar me shkresa zyrtare duke na kërkuar sqarime ashtu siç ka obliguar vendimi i OSHP, duke shkelur vendimin ne fjale dhe duke na diskriminuar , duke mos na trajtuar si pale me interes ne këtë AP , edhe për kundër se kemi tenderuar me çmimin me te lire dhe kemi plotësuar te gjitha kriteret e përzgjedhjes, si dhe kemi tenderuar ne pajtim te plote me nenin 28 te LPP-se konkretisht Aneksin 1 te FDT-se, duke tenderuar dhe duke prezantuar katalogun e produkteve me te cilat do te ekzekutohet behët DDD ne pajtim me karakteristikat mjedisore, standardeve Evropiane (ne pajtim me miratimin teknik Evropian) dhe ne pajtim te plote te standardeve ndërkombëtare, po ashtu edhen pajtim me standardet e Republikës se Kosovës te cilat janë te harmonizuar me Direktiva te BE-se dhe licencave te cilat kërkohen për importin e preparateve për DDD si nga MMPH dhe nga MNPZHR te cilat e rregullojnë fushën e DDD ne Republikën e Kosovës.

AK nuk ka respektuar Vendimin e OSHP nr. 2023/0283 te datës: 24.07.20203, për faktin sepse ky vendim e Obligon AK qe gjate faze se Ri-vlerësimit te beje hulumtimin e këtyre preparateve me substanca aktive te ngritura ne pretendimet ankimore te OE ankues FLOMED SHPK, dhe pas një konstatimi te SAKTE, nëse këto preparate janë te lejuara atëherë te filloj ta beje RI-vlerësimin e ofertave ne te kundërtën ta anuloje AP.

Duke marr për bazë ketë fakte, analizën e rrjedhës se këtij aktiviteti te prokurimit kësaj procedure, ANEKSIN 1 te FDT-se, Katalogun e preparateve te cilat ne kemi dorëzuar me rastin e tenderimit, ku ne katalogun preparateve te ofruar nga ana jone nuk te gjitha preparatet janë EKOLOGJIKE ne pajtim te plote me standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe sipas Licencave te lëshuar nga MMPH dhe MBPZHR dhe ne pajtim me Aneksin1 te Dosjes se tenderit, pasi qënëse STUDIOHET dhe ANALIZOHET ky Anekse askënd nuk përmendë emra apo specifikat qe i referohet një produkti apo artikullit e caktuar po thotë, po citoj: "**Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt te njëjte**" qe do te thotë se bazuar ne dokumentet e tenderit, ANEKSI 1 , Katalogun e prezantuar nga ana jone ky AKTIVITET I PROKURIMIT është anuluar ne kundërshtim me **nenin 62 te LPP-se**, sepse nuk janë plotësuar kushtet e nenit 62 te LPP-se per anulimi e këtij Aktiviteti te prokurimit.

AK ka shkelur vendimin e **OSHP nr. 2023/0283 te datës 24.07.2023**, për faktin se PSH e ka obliguar AK te na kërkoj sqarime ne pajtim me **nenin 72 te LPP-së**, mirëpo AK vepruar ne kundërshtim me Vendimin ne fjali pasi qe nuk ka kërkuar sqarim fare.

Një prej arsyeve te anulimi te këtij aktivitet te prokurimit nga AK është sepse nuk është SIGURUAR dhe nuk ka arsyetuar anulimi e këtij AP, sepse nuk janë plotësuar kushtet per anulimi e kësaj procedure t prokurimit per faktin sepse preparate e ofruara nga ana jone ne katalogun te cilën kemi prezantuar janë ne pajtim te plotë me te gjitha standardet evropiane **DIREKTIVAVE TE BE-se** dhe standardeve ndërkombëtare.

KY aktivitet i prokurimit është anuluar ne kundërshtim me **nenin 59 dhe 62 te LPP-së**, për faktin se OE FLOMED SHPK është palë pa interes sipas **nenin 4 par. 1.26 të LPPsë,,** për faktin se nga data e njoftimit për kontrate te datës: 10.06.2022 (kur është publikuar ne platformën elektronike e-prokurim), OE FLOMED SHPK asnjëherë nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas **nenit 53 te LPP-së**, si dhe as Kërkesë për Rishqyrtim sipas **nenit 108/A te LPP-së** (Prove: Platforma elektronike), mirëpo vetëm pas tenderimit – procesverbalit te hapjes i cili është radhitur si tenderuesi me numër rendorë 6 (gjashtë) nga gjithsejtë 7 (shtatë) tenderues/ofertues ne këtë aktivitet te prokurimit, që do të thotë se fillimisht PSH është vënë ne lajthitje nga **Eksperti TEKNIK i jashtëm z. Fitim Sopjani**, i cili me rastin e trajtimit te pretendimeve ankimore te OE ankues FLOMED SHPK ka vepruar ne kundërshtim me **nenin 114 të LPP-së**, (*si dhe informimin publik te lëshuar nga OSHP me date: 09.02.2023 ne web. faqen e OSHP*) sepse përveç qe ky OE ankues (Flomed Shpk), ka qenë pa interes juridiko material ne këtë aktivitet te prokurimit, eksperti ne fjalë nuk ka qenë as njohës te fushë dhe nuk ka gjykuar drejte problemin duke e vendosur ne lajthitje PSH duke aprovuar si te bazuar ankesën dhe duke rekomanduar përmirësimin e specifikimeve teknike ne baze te ligjit dhe rregulloreve dhe direktivave, gjë qe ka NDIKUAR tek PSH te aktivizoj INTERSIN PUBLIK (pasi qe normalisht PSH nuk janë njohës te kësaj fushe DDD-se dhe sigurisht mund te ndikohen nga ESH për shkak te frikës se mos po rrezikohet SHENDETI PUBLIK). Mirëpo kjo ankese sipas LPP-se është dashtë te hodhët si palë pa interes juridiko material, nga eksperti dhe sigurisht edhe nga PSH, sepse te gjitha faktet dhe provat e argumentoj një gjë te tille ne platformën elektronike – fakte te pa mohushme!?.... SI DHE NUK KA NGRITUR ASNJE PRETENDIM LIDHUR ME OFERTEN TONE!?.....

Krejt kjo rrjedhje ne këtë procedure te prokurimit ku PSH e obligon AK te SIGUROHET AK se këto preparate nuk prekin shendin publik vjen nga mos trajtimi i drejtë i problemit, fillimisht nga OE ankues FLOMED SHPK si palë pa interes juridiko material sipas **nenit 4 par. 1.26 te LPP-së**, sepse asnjëherë nuk ka kërkuar sqarime dhe as kërkese për rishqyrtim pran AK dhe ka pranuar te tenderoj me këto kriteret e përzgjedhjes dhe aneksin 1 te FDT-së, e ku deri ne hapjen e këtij AP i cili ka ndodhur me datën: 15.02.2023 afërsisht një vite nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, dhe deri në këtë date ka pas sqarime shtesë dhe KpR nga disa OE te interesuar, ku kanë ngritur pretendime ankimore lidhur me Specifikat teknike – Aneksin 1 te FDT-së siç është rasti ku AK me datën: 09.11.2022 nxjerr vendim mbi refuzimin e KpR ku është atakuar neni 28 i LPP-së – specifikimet teknike ne dosjen e tenderit ANKESIN 1 dhe aty arsyetohet dhe Konstatohet se këto specifikimet teknike janë ne pajtim te plotë me nenin 28 te LPP-së, dhe kjo ka qene e pranueshme për OE pjesëmarrës ne këtë AP,

sepse s'ka pas ankesa dhe janë ne harmoni me direktivat e BE-së dhe standarde dhe licencat qe kërkohen për produkte dhe artikuj te ndryshëm për DDD ne Republikën e Kosovës.

Prandaj, EKSPERTI SHQYRTUES nuk ka qenë profesional dhe ka vepruar ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-së duke e vendosur ne LAJTHITJE PSH, po ashtu AK – Komisioni i vlerësimit – ZPP duhet te konstatojnë dhe te veprojnë ne harmoni me dispozitat ligjore te LPP-së si dhe ne respektimin e INSTITUCONEVE kompetentet e cilat e rregullojnë ketë fushë ne Republikën e Kosovës, pasi qe marr për bazë SPECIFIKIMIN TEKNIKE NE ANKSIN 1 të FDT-së, si në vijim:

Largimi	**i**	**zvarranikëve**
aparateve	apo	vetëm

– Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m2 për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m2 për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Ku, Eksperti qe ka trajtuar këtë pretendim (konstatohet fakti se nuk kane njohuri për vet fikin se ka kërkuar sqarime nga MMPH) duke ju drejtuar Sekretarit te MMPH lidhur me produktet e OE te rekomanduar për Kontrate: **Doctor Exterminator DDD SHPK** lidhur me substancën aktive SULFUR me përshkrim **Snake – A – Way – Snake – repelling – Granules–Repelent!.....**

Pra nëse analizohet ne detaje Aneksi1 i FDT-se askënd nuk përmendet reparti sulfer por repelent – ekologjik, dhe ky pretendim i OA ankues Flomedshpk ka qenë për OE te rekomanduar për dhënie te kontratës**DoctorExterminator DDD SHPK**, por jo për produktet qe **ne kemi ofruar ne katalog** dhe nuk ka te beje me preparate qe ne kemi ofruar ne katalog, sepse ne kemi ofruar preparate ekologjike dhe ne pajtim te plote me standarde evropiane

dhe ndërkombëtarë sipas direktivave te BE-se.**(*Prove katalogu ynë*)**

Gjithashtu, Ekspertet ne raportin e tyre lidhur me preparatet qe ka prezantuar OE FLOMED SHPK ne këtë aktivitet te prokurimit potencojnë se po citoj: "*Gjithashtu vlen te cektë se edhe oferta e OE ankues (Flomed SHPK) posedon preparate te ndaluara për përdorim*" qe dot e thotë se tashme konstatohet se ky OE ankues FLOMED SHPK është palë pa interes sipas **nenit 4 par. 1.26 te LPP-së**, sepse qëllimi i tij i vetëm është te dëmtoj AK dhe te mos lejoj te lidhe kontrate edhe përkundër se është i papërgjegjshëm duke mos arritur te plotësoj kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimin teknik te dosjes se tenderit, ATEHERE KONSTATOHET DHE VERTETOHET PRETENDIM YNE I DREJTE se eksperti teknik te OSHP ka dhënë një rekomandim te gabuar (**apo ka qen i ndikuar dhe i mungon njohja e ligjit si frymon, sepse si ligj mund ta ketë lexuar po je edhe kuptuar si frymon, përves kësaj asnjë bazë – dispozite ligjore te LPP-së, apo edhe te ndonjë ligji tjetër nuk është thirre, kur ka aprovuar ankesën e OE Flomed Shpk qe argumenton pretendimin tonë se është dhe ka qenë tërësisht jo njëkohës i prokurimit por edhe i fushës se ngushtë profesional DDD**),duke e frikësuar PSH se është duke u prekur interes publik – shëndeti publik, mirëpo ky mos profesionalizim dhe ekspertit teknike te OSHP-së, nuk duhet te reflektohet tek AK – ZPP, por te konstatohet drejtë, saktë problemi dhe të VERTETOHET se specifikimi teknik nga ana e AK ne aneksin 1 te Dosjes se tenderit është ne pajtim te plotë me standardet dhe direktivat e BEse (**përveç kësaj sikur te kishin bazë ligjore OE ankues që kanë ngritur pretendime ankimore lidhur me specifikimin teknik do te ju drejtoheshin OSHP para datës se hapjes për këtë aktivitet te prokurimit e sigurisht edhe OE ankues FLOMED Shpk, mirëpo një gjë e tillë është e pa mundur te konstatohet se ky specifikacion është ne kundërshtim me nenin 28 të LPP-së si dhe me standarde evropian dhe direktivave te BE-se dhe ky OE ka pranuar këto kushte dhe tani nuk mund ti kontestoj dhe s'ka te drejt dhe baze ligjore për trajtimin e tyre).**Prandaj kërkojmë nga AK te analizoj edhe një herë dhe te konstatojë se specifikimi teknik është ne pajtim me **nenin 28 te LPP-se**, si dhe preparate e ofruar nga ana jone ne katalogun qe kemi dorëzuar me rastin e tenderimit është ne pajtim te plotë me aneksin 1 dhe standarde evropiane sipas direktivave te BE-së, pasi qe ne kemi prezantuar te gjithë preparate tone ne katalog ekologjike dhe nuk RREZIKOJNE SHENDETIN PUBLIK, përkundrazi jene te testuar dhe licencuar sipas standardeve evropiane. DHE EDHE SIKUR TE KTHEHEJ NE RITENDERIM PERSERI AK NUK KA QKA TE SPECIFIKOJ NDRYSHE SEPSE KY ESHTE PASTRIM I DDDSE DHE KETE E BEJNE OE TE CILET JANE PROFESIONAL DHE AK VETEM DUEHT TA MENXHOJ DEH KONTROLLOJ!.....

DHE duke marr për bazë te gjitha faktet dhe provat lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, si dhe Vendimin e OSHP-se - PSH, ku ka aprovuar ankesën tone si te bazuar dhe ka detyruar AK te kërkoj sqarime shtesë dhe te respektohen dispozitat ligjore te LPP-së, si dhe OE ankues

FLOMED SHPK nuk ka ngritur asnjë pretendim lidhur me ofertën/tenderin tone ne këtë aktivitet te prokurimit, dëshmohet se ky OE ankues është pale pa interes sipas **nenit 4 par. 1.26 te LPP-së**, dhe ky OE ka vetëm një qellim qe te arrij te vendos ne lajthitje AK, ESH dhe PSH qe kjo procedurë e prokurimit te anulohet dhe lënda te shkoj ne RITENDERIM, TI JAP EDHE NEJ MUNDESI VETI PER TE FITUAR, pasi qe nuk ka arrite te ofertoj me çmimin me te ulët dhe te plotësoj kriteret e përzgjedhjes, prandaj te pasojnë OE te përgjegjshëm për fajin OE te cilët janë te pandërgjegjshëm dhe pa përgjegjshëm, si dhe te pasojnë AK, duke dëmtuar edhe ne ketë mënyrë **INTERESIN PUBLIK DHE SHENDETIN PUBLIK** - sepse edhe mungesa e DDD për AK – Policin e Kosovës ne nivel vendi përbën dhe prek interesin publik dhe shëndetin tyre dhe publikut, andaj **KERKOJM NGA AK TE PERDORE AUTORITETIN VETE DHE TE KONSTATOJ DHE ARUMENTOJ PARA PSH – OSHP DHE TE VAZHDOJM ME RESPEKTIMIN E DISPOZITAVE LIGJORE TE LPP-SE NE FUNKSON E PERMBUSHJEES S EDETYRIMEVE DHE OBLIGIMEVE LIGJORE QE RJEDHIN NGA AUTORITET KONTRAKTUES – NE KETE RAST POLICIA E KOSOES.**

[Për faktin se ne jemi OE i përgjegjshëm, pasi qe përveç qe kemi plotësuar kriteret e përzgjedhjes, specifikimet teknike ne kemi prezantuar edhe listën e punëtoreve me ATK për te cilët paguajma kontribute qe do të thotë dhe KONSTATOHET se ata janë punëtorë qe punojnë për kompani tonë dhe janë profesional ne fushën e DDD, qe do të thotë se duhet ti besojmë institucioneve tona relevante siç është ATK-ja qe dëshmon dhe argumenton se janë punëtor tanë dhe gabimet me kontrata janë relevantë dhe plotësisht gabime teknike qe bazuar ne **nenin 59 par. 4 te LPP-së**, parqet vetëm devijim e cili nuk ndikon ne aspektin material dhe formal, andaj duhet te rekomandohemi për dhënie te kontratës ne këtë AP si tenderues me çmimin më të lirë, duke plotësuar te gjithë dispozitat ligjore te LPP-së dhe licencat për importin e preparateve ekologjie dhe sipas standardeve evropiane ne harmoni me direktivat e BE-së.

Prove: Askënd ne raportin e ekspertit dhe vendimin e OSHP nr. 2023/0283 nuk shkruan se ne si tenderues nuk kemi preparate sipas standardeve evropian apo nuk kemi plotësuar ndonjë specifikim teknik apo kriter te përzgjedhjes!..... Por aty shkruan se OE ankues **Flomedshpk** dhe **OE i rekomanduar për kontratë janë te papërgjegjshëm,** ndërsa për ne si tenderues ka detyruar AK te kërkoj sqarime shtese sipas **nenit 72 te LPPsë**, duke hapur rrugën për AK te vërtetoj dhe te na rekomandoj për dhënien e kontratës, dhe nëse pastaj ka palë te interesit dhe te pa kënaqur sigurisht do te vazhdojnë me ankese pran OSHP-së, dhe te zgjidhet kjo procedure e prokurimit pa u anuluar ne tërësi sepse ne jemi te bindur se është shkelur neni 62 i LPP-së, me rastin e anulimit sepse AK nuk ka arrit te KONSTATOJ se është prekur interesi publik – shëndeti publik, por me përfundimin e kësaj procedure sipas

dispozitave ligjore te LLP-së rrezikon qe vërtet te preket SHENDETI PUBLIK – zyrtareve policore ne nivel vendi, këtë do ta dëshmojmë edhe para AK (**ku me mirëkuptim dhe argumente dhe fakte ne dispozita ligjore te LPP-se kemi argumentuar dhe kërkojmë aprovimin nga AK – ZPP te ndërmarr hapat për rekomandimin për dhënie te kontratës ne si OE te përgjegjshme duke shterur edhe këtë te drejt dhe obligim ligjore**) dhe nëse është e nevojshme edhe para OSHP, do kërkojmë te mbrojmë drejtësinë tonë!.....

Po ashtu ne ESH teknik ne shkresën drejtuar MMPH (ku sipas raportit nuk shihet saktë se kujt i drejtohet, por pyetja ka qenë shumë tendencioze sikurse ky ESH është ne konflikt me AK dhe MMPH (***duke pas si mision anulimin e këtij AP – ne dyshojmë se është ne konflikt te interesit ne këtë lëndë – SEPSE NESE ANALIZOHET ANEKSI 1 I DOSJES ESE TENDERIT, PYETJA E EKSPERTIT DREJTUAR MMPH QARTE VREHET SE SKAN LIDHSHMERI FARE NJERA ME TJETERN, DHE KREJT KJO ESHTE E PA BAZUAR DHE ME QELLIM PER TE ANULUAR KETE PROCDEURE PROKURIM***) duke luajt rolin e mbikëqyrësit te MMPH, mirëpo përgjigje e cila është ofruar nga **z.Maxhari – zyrtar për produkte biocide – MMPH**, askënd nuk ka potencuar se ky produkti APO KETO PREPERAT (këto JANE TE i ndaluar, por përkundrazi ka potencuar se është i lejuar për import duke respektuar rregulloret e BE-se me te dhënat e substancave aktive, pa specifikuar me tepër, kurse AK jap një arsyetim përtej kësaj duke tejkaluar kompetencat e veta me arsyetimin e dhënë me rastin e eliminimit te këtij aktiviteti te prokurimit ku thotë, po citoj: "*AK sipas vendimit te OSHP ka konstatuar me ministrin përkatëse te cilat na konfirmojnë se produkti i ofruar per repelent me substanca primare sulfur dhe me përqindje pre 28% nuk është i lejuar te përdoret me dhe ne përgjithësi nuk lejohet qe sulfuri te jete substance primare. Andaj AK pas situatës se krijuar është e pamundur vlerësimi i drejt i OFERTAVE dhe respektimi i nenit 7 dhe 59 te LPP-se duke pas parasysh shëndetin publik dhe veçanti zyrtareje policore*" Në Shkresat nga z. Maxhera nuk thuhet se nuk lejohet te përdoret sulfat me përqindje 28%, por nëse ka ndonjë shkresë tjetre qe argumenton saktë dhe dëshmon atëherë te prezantoj sepse me rastin e anulimi nuk e ka prezantuar dhe konstatojmë se ky aktivitet është anuluar pikërisht ne shkelje te **nenit 7 dhe 59 te LPP-së**, duke shkelur edhe nenin 62 te LPP-se, sepse sipas standardeve evropiane dhe direktivave te BE-se, dhe rregullave dhe ligjeve ne Fuqi ky preperat sulaft deri ne përqindjen 28% lejohet te përdoret, por mbi këtë përqindje nuk lejohet te përdoret, si dhe te merret për bazë koha e publikimit te kësaj procedure, aneksi 1 dhe katalogu i dorëzuar nga ana jone, dhe te vihet ne veprim ne tërësi dispozitat ligjore te LPP-së, dhe sigurisht te merret për bazë është SHENDETI PUBLIK - zyrtareve policore, sepse ne jemi OE te përgjegjshëm dhe me tepër vihet ne rrezik shëndeti publik – zyrtareve policore me anulimi e këtij aktiviteti te prokurimit se sa te vazhdohet dhe te shpërblehemi me kontrate, pasi qe ne sigurojmë AK se preparate tona ashtu siç kemi prezantuar ne katalog por edhe me rastin e përdorimit dot e prezantojmë Safety data Sheet dhe licenca për importin e tyre

Gjithashtu, duke studiuar dhe analizuar rrjedhën e kësaj procedure te prokurimit nga data e NJK deri me sot ku ka një periudhe afërsisht 2 (dy) vite ne konsiderojmë se fillimisht Ankesa nga FLOMED SHPK si pale pa interes sipas **nenit 4 par. 1.26 te LPP-së**, e cila është trajtuar

nga ESH, duke e vendosur PSH ne lajthitje te rrezikimit te shëndetit publik, duke mos e lejuar te hudhe ankesën e OE FLOMED si pale pa interes ka ndikuar qe te shtrembëroj konkurrencën dhe involovohen edhe shume pale te tjera qe te përdorin Autoritetin e tyre për interesa te caktuar apo te grupeve te caktuar ne demet e kompanisë tone dhe ne dem te Interesit Publik – Shëndeti te Policisë se Kosovës duke i 'ja pamundësuar te lidhe kontrate për këtë aktivitet te prokurimit, sepse analizuar dhe marr për baze standarde evropiane dhe ndërkombëtarë, si dhe Direktivat e BE-se, AK s'ka se si te ndryshoj dhe te jap tjetre specifikim teknik përveç se te analizoj preparate e tone e prezantuar ne katalog dhe te konstatoj se janë ekologjike dhe sipas standardeve evropiane, sepse ne jemi OE te përgjegjshëm dhe profesional ne fushën e DDD për shume vite ne RKS. Po ashtu ne do te konsultohemi edhe me avokatin e firmës tone dhe nëse ka ndonjë shkelje te përgjegjësive qe rrjedhin nga ndonjë pale qe ka qene pjese e direkt apo indirekt e këtij aktivitet te prokurimit, do fillojmë procedura për te ju drejtuar institucioneve kompetentet.

AK ka shkelur Vendimin e PSH nr. 2023/0283 te datës: 24.07.2023, pasi qe nuk na ka kërkuar sqarime sipas nenit 72 te LPP-se. Po ashtu nëse analizohet dhe vlerësohet katalogu ynë sipas FDT-se, aneksit 1 ne kemi ofruar preparate ekologjike dhe qe janë ne harmoni me normat e lejuar evropiane dhe standardeve te Republikës se Kosovës ne harmoni te plote me licencat dhe rregullave te importeve te preparateve ekologjike. Shkresat dhe komunikimi me zyrtaret e MMPH siç janë shkresat e z. Maxhera nuk e përjashton Specifikimin teknik dhe preparatet tona janë ne harmoni te plote me standardet evropiane dhe nderkomtare, pasi qe kemi preparate ekologjike qe sigurojnë shëndetin publik – zyrtareve policore, prandaj jemi OE i përgjegjshëm me çmimin me te lirë dhe ne ketë aktivitet te prokurimit nuk gjen zbatim neni 62 i LPP-së.

Sqarim	**për**	**ESH**	**deh**	**PSH**	**si**	**ne**	**vijim:**

Ashtu sic kemi sqaruar edhe me lart se specifikimi ne aneksin 1 te FDT-se ku thotë: *Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.*

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK, duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK. Kjo dëshmon se ky specifikim është ne përputhje te plote me nenin 28 te LPP-se, dhe nëse analizohet katalogu ynë dhe licencat qe kemi ofruar atëherë kjo dëshmon se ne jemi ne pajtim te plot me specifikimin teknik.

Gjithashtu, nese analizohen me kujdes pa ndikim dhe duke njofto frymën e ligjit për DDD dhe preparate e nevojshëm per këtë lami, dhe shkresat dhe komunikimin mese AK – dhe z. Maxhera nga MMPH, atëherë qarte konstatohet se preperat tona ne katalogun tone janë te lejuar dhe ekologjike, po ashtu duke marr per baze se preperati ekologjik REPELENT si granulë per largimin e zvarranikeve me efekt optimal, siguristh behet ne disa zona ku stacionet policore jenë ne vise rural(qe do te thotë se zvarraniket janë ne pjese rurale ku lëvizja e qytetareve dhe zyrtarëve policore është e vogël dhe larg hapësirës ku përdoret ky preparate

sepse, kjo ka kuptimin e parandalimit te zvarranikeve dhe sigurisht vendoset jashtë objekteve dhe ne distanca larg objekteve policore dhe aspak nuk përbën rrezik per shëndetin publik) dhe jo ne qytete qe dot e thotë se përdorimin e këtij preperati Repelent, përveç qe është i lejuar sipas **ligjeve ne RKS dhe standardeve evropiane, nuk paraqet rrezik aspekt për SHENDETIN PUBLIK**, andaj lusim nga ESH ti trajtoj dhe analizoj shkresat e AK dhe përgjigjet e MMPH qe argumentohet se AK nuk ka baze për te anuluar këtë AP sepse askënd nuk thuhet konkretisht se këto preparat janë te ndaluara, dhe nuk janë plotësuar kushtet për anulimi e këtij aktiviteti te prokurimit, sepse nuk është KONSTATUAR nga AK se këto preparat janë te ndaluar dhe përbejnë rrezik për shëndetin publik, po ashtu ne kemi arritur te plotësojmë te gjitha kriteret e përzgjedhjes, aneksin 1 – specifikimin teknik si dhe kemi tenderuar me çmimin me te ulet duke plotësuar kriterin e dhënies se kontratës, prandaj me te drejt dhe me fakte dhe argumente konstatojmë se bazuar ne shkresat dhe përgjigjet e AK – PK si dhe MMPH ky aktivitet i prokurimit është anuluar ne kundërshtim me **nenin 62 te LPP-se**, sepse nuk janë plotësuar kushtet dhe kriteret për anulimi e këtij aktiviteti te prokurimit, si dhe nuk është vlerësuar drejt nga AK duke vepruar ne kundërshtim me **nenin 6, 7 dhe 59 te LPP-se.**

Prandaj duke marr per baze se AK – ZPP ne refuzimin e kërkesës për rishqyrtim te datës 15.08.2023 ku nuk është përgjigjur fare, duke mos i trajtuar fare pretendimet tona ankimore, duke shkelur nenin 47 dhe 52 te Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative sepse përveç vendimit te OSHP, ka qen i obliguar te konstatoj dhe argumentoj dhe te jap arsyetime te pa mbështetur ne dispozite ligjore te LPP-se dhe jashtë specifikimeve teknike te përcaktuar ne Dosje te tenderit, sepse këto arsyetime nga AK – ZPP nuk janë te kërkuar ne specifikimin teknik te Dosjes se tenderit pasi qe askënd nuk specifikohet përqindja e sulfurit si dhe nëse analizohet katalogu dhe preparate tona te ofruar per largimin e zvarranikeve askënd nuk përmendet përqindja e sulfurit, dhe marr per baze vlerësimin, ekzaminimin dh krahasimin e tenderëve AK ne rastin tone na ka diskriminuar dhe ka shkelur nenin 59 te LPP-se, **pasi qe NE si grup i OE jemi te përgjegjshëm sipas Dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate dhe plotësojmë kushtet e nenit 60 te LPP-se, pasi qe askund ne aneksin 1 te FDT-se nuk është cekur Sulfuri dhe as përqindja e tija, po ashtu edhe produktet tona ne katalog janë ekologjie dhe nuk specifikon sulfurin qe do te thotë pastrimi i DDD nga ana jone është pa sulfur dhe ekologjik. *Prove katalogu ynë***

Po ashtu AK - ZPP është ne kundërshtim me vetveten kur e refuzon kërkesën tone per rishqyrtim, sepse thotë: vlerësimi është i pamundur duke respektuar LPP, ndërsa me poshtë thotë: andaj mbi bazën e këtyre AK nuk bere rivlerësimin sepse: preparatet me përqindje sikurse ne faqen nr.3 te këtij vendimi, pikërisht duke shkelur nenin 7 te LPP-se, sepse referuar katalogut tone dhe preparateve tona te ofruara per këtë aktivitet te prokurimit, si dhe licencave dhe lejeve per import te preparateve konstatohet se preparateve substanca aktive janë te lejuar nga MMPH dhe nuk përbën rrezik per shendin publik ne asnjë rrethanë përdorimi i këtyre preperatve, qe normalisht janë te lejuar nga MMPH dhe jane ne përputhje me standardet evropiane siç është **ECHA** – ne Bashkimin Evropian . **Vlen te cekte se preparate tona nuk permbajn sulfur bazuar ne katalogun te prezantuar nga ana jone per kete aktivitet te prokurimit dhe AK me rastin e Anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit ka shkelur nenin 59 dhe 62 te LPP-se.**

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u ceken me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 62 te LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edh kriteri kryesore për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas nenit 60 paragrafi1.1 i LPP-së.

Por pavarësisht nga sqarimi ynë si më lartë ne konsiderojmë se kemi arrit te plotësojmë Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te vendosura nga AK – ZPP ne dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate, dhe janë plotësuar te gjitha kushtet dhe dispozitat ligjore qe te rekomandohemi per dhënie te kontratës lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, pasi qe kemi plotësuar edhe Kriteret e Dhënies – tenderi me çmimin më të ulët të përgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu nuk është respektuar edhe **neni 7 i LPP-se**, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar te gjitha kërkesat e FDT-se dhe te njoftimit për kontrate. Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyre te barabartë dhe jo-diskriminues dhe dot e veproj ne mënyrë transparente".

Po ashtu **paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së** e parasheh qe "gjate udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit te gjitha autoritetet kontraktues do te sigurojnë; qe *(vi) tenderi i zgjedhur te përputhet me te gjitha aspektet përmbajtjesore te kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse*", kurse OE i rekomanduar per kontrate është i papërgjegjshëm.

Gjate zhvillimit te kësaj procedure nuk është marr ne konsideratë edhe **neni 1 i LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjerat e autoriteteve kontraktues ne Kosovës.

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe argumentet qe u ceken mel arte, kërkojmë fillimisht nga **ESH te hulumtoj dhe te trajtoj drejt me fakte dhe prova – shkresat nga MMPH standardet evropian dhe baza ligjore ne RKS dhe standarde e Kosovës – si dhe nga PSH - OSHP**, qe te merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e GOE: **S.V. Veterina & NNP "WENDA"**
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-se per anulimi e aktivitetit te prokurimit dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM** dhe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi I ofertave te behet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave ligjore te LPP-së.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 200,000.00 euro.**	**Dëshmia 1. OE duhet te dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit prej jo më pak se 200,000.00 euro..**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kërkesa 1. Stafi profesional për shërbimet e DDD:3 Punëtorë teknik**	**Dëshmia 1. Listën e stafit profesional për shërbime të DDD nënshkruar dhe vulosur nga OE.Minimum Tre (3) punëtorë teknik me eksperiencë në lëminë e DDD-së. Me Dy (2) vite përvojë pune të dëshmuar me referencë . Me Kontratë pune ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin për angazhim për këtë projekt.**
		Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri vitet e shkuara në vlerë prej 100,000.00 € deri në publikimin e njoftimit për kontratë.	**Dëshmia 2. Një Listë e Shërbimeve të natyrës se ngjashme të realizuara në tri vitet e shkuara duke saktësuar Shërbimet e kryera , shumën e kontratës vendin, datën si dhe nr. e prokurimit, kjo listë duhet te jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga kompania (origjinal), të dëshmuara me referenca pozitive ose raportet e pranimit si dëshmi se kontrata është përmbushur me sukses. (kopje).**
		Kërkesa 3. OE duhet të dorëzoj metodologjinë e punës dhe preparatet e parapara për përdorim.	**Dëshmia 3. Përshkrimi i detajuar i Metodologjisë se punës dhe preparatet për realizimin e shërbimeve. Vërejtje të gjitha preparatet e parapara duhet të jenë të lejuara me ligj.**
		Kërkesa 4. OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosur nga OE me pajisjet ne vijim **Së paku 1 pompë motorike – Gjenerator ULVSë paku 5 pompa motorike dhe pajisje të tjera përcjellëse.**	**Dëshmia 4.OE duhet të ofrojë listën e pajisjeve të kërkuara për kryerjen e shërbimeve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. Në rast se këto pajisje janë të vetat, atëherë duhet të dëshmohet me foto dhe deklaratë mbi posedimin e tyre, nëse janë të marra me qera atëherë te dëshmohet me marrëveshje mbi marrjen me qera për projektin në fjalë.**

		Kërkesa 5. OEduhet të ofroj Katalog ose broshurë për të gjithë artikujt me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara.	**Dëshmia 5. Katalog ose broshurë për të gjithë artikujt me detaje të mjaftueshme për vlerësim.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Policia e Kosovës anulon aktivitetin e prokurimit ne pajtim me nenin 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit pas hapjes se ofertave l
shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përm
amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të pr

Arsyetim Komisioni i vlerësimit duke ju referuar vendimit te OSHP-së me numër 2023/0283 te datës 24/07/2023 I cili e obligon AK P
Kosovës qe te veproje si ne vijim citoj "andaj paneli shqyrtues konform gjendjes së krijuar e klasifikon pjesërisht te bazuar ankesën e
Obligon autoritetin kontraktues Policia e Kosovës qe gjate fazës se ri-vlerësimit fillimisht te beje hulumtim te këtyre preparateve me s
aktive te ngritura ne pretendimet ankimore ne ankesën 283/2023, dhe pas një konstatimi te saktë nëse këto preparate janë te lejuar atëh
filloje te beje ri-vlerësimin e ofertave ne te kundërtën ta anuloje aktivitetin e Prokurimit pasi vije ne shprehje shëndeti publik. Pastaj n
interes ta ri-tenderojë dhe ti beje përmirësimet e domosdoshme ne dosjen te tenderit.
Sipas ekspertizës dhe sipas gjendjes se ofertave te dorëzuar dhe produktet e tyre nuk lejohet përdorimi tyre sipas ndryshimeve te rregu
ndërkombëtarë, po ashtu pas konfirmimit nga ministria përkatëse se këto preparate janë të ndaluara.
AK sipas vendimit te OSHP ka kontaktuar me ministrin përkatëse te cilit na konfirmojnë se produkti i ofruar për repelent me substanc
sulfur dhe me përqindje pre 28% nuk është i lejuar te përdoret më dhe ne përgjithësi nuk lejohet qe sulferi te jetë substance primare.
Andaj AK pas situatës se krijuar është e pamundur vlerësim i drejt i ofertave dhe respektim i nenit 7 te LPP dhe nenit 59 pasi nuk mun
gjithë ofertuesit ti trajtojmë te barabartë dhe vlerësimi sipas nenit 59 është i pamundur.
Duke pasur parasysh shëndetin publik dhe ne veçanti shëndetin e zyrtarëve Policor AK anulon aktivitetin e prokurimit ne tërësi dhe m
rishikoje specifikat teknike për te ritenderuar me pas..

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Sqarimet e marra përmes emailit te datës 04.09.2023 dhe 06.09.2023 nga AK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP me nr. 2023/0283 i datës 24.07.2023

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **S.V.„Veterina**

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me sqarimet qe AK është e obliguar te beje për preparatet me substanca aktive dhe vendimit te PSH me nr. 2023/0283 eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa e specifikimit teknik pjese dosjes se tenderit ka qenë:

Largimi i zvarranikëve – Për kryerjen e këtij shërbimi të përdoret njëri lloj i këtyre aparateve apo vetëm granulat.

1 - Aparate me vibrim për dëbimin e zvarranikëve me bateri që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 300 - 400 m² për largimin e Zvarranikeve, të qëndrueshëm ndaj lagështisë. ose

2 –Aparate solare me vibrim për dëbimin e zvarranikëve që vendosen në tokë.

- Sipërfaqja 600 – 700 m² për largimin e Zvarranikëve të qëndrueshëm ndaj lagështisë.

3 – Preparate repelente ekologjike si granula për largimin e zvarranikëve me efektivitet optimal.

Për çështje të sigurisë së tyre në lidhje me origjinën e produkteve tenderuese dhe lejen për përdorim në RK,duhet të paraqesë edhe lejen e importit të produkteve të lëshuar nga Ministria e Ambientit Hapësinor në RK.

Pretendimi i OE ankues se AK-ja ka qenë e obliguar që të kërkojë sqarime nga OE pjesë e aktivitetit të prokurimit është pjesërisht i qëndrueshëm sepse vendimi i PSH e obligon të bëjë hulumtim te këtyre preparateve me substanca aktive te ngritura ne ankesën 2023/0283 por jo detyrimisht me OE pjesë të procedurës te cilën AK-ja e ka bërë me zyrtarët për produktet biocide pranë MMPH.

Sa i përket pjesës se pretendimit ku OE ankues i referohet Aneksit 1 te dosjes se tenderit "Lejohet për përdorim edhe preparati ekuivalent me efekt te njëjtë" eksperti shqyrtues sqaron se pjesa e specifikimit teknik për "largimi i zvarranikeve" nuk e ka fjalinë te cilën i referohet OE ankues. Sidoqoftë të njëjtat janë bazuar ne LPP-ne neni 28 paragrafi 7 .

Sa i përket pjesës se pretendimit se OE Flomed është palë pa interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-se eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim nuk qëndron sepse para se ankesa te pranohet për shqyrtim i bëhet vlerësimi nëse OE ankues është palë me interes dhe pastaj shqyrtohet ankesa. Fakti qe ankesa e OE është shqyrtuar dhe vendosur nga PSH e vërteton se pala ankues është palë me interes sipas nenit 4 paragrafi 1.26 te LPP-se.

Pretendimi i OE ankues qe ka te bëjë me preparatet e dorëzuara me ofertën e tij dhe arsyetimi se preparatet qe ka dorëzuar janë ekologjike bazuar ne katalogun e OE ankues DHE "*Funksioni është vetëm për të mbajtur zvarranikët (të tillë si gjarpërinjtë) larg zonës së trajtuar, pa qenë të dëmshëm për ta, mjedisin dhe kafshët e tjera*." Bazuar ne "Safety Data Sheet" i produktit te rrezikshmëria e produktit është i klasifikuar si H317 dhe H412 e cila me rregulloren Nr. 1272/2008 e Parlamentit Evropian e definon si **"te dëmshëm për organizmat ujor me efekte te përhershme"** Prandaj ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Vlen te theksohet se ne dosje te tenderit nuk është kërkuar përmbajtja e produkteve apo "Safety Data Sheet" për produktet e ofruara nga OE pjesëmarrës ne aktivitet te prokurimit.

Sa i përket pretendimit ankimor te OE ankues qe ka te bëjë me pjesën ku i referohet preparatit te sulfurit dhe deklaratës se i njëjti lejohet deri ne 28% nuk qëndron sepse kjo është sqaruar përmes komunikimit te AK-se dhe zyrtareve te MMPH ku n baze te rregullës se re përmbajtja e sulfurit nuk është e lejuar me përqindjen si me lartë.

Vlen te ceket se OE ankues ne pretendimin e tij cek ***"pasi qe ne sigurojmë AK se preparate tona ashtu siç kemi prezantuar ne katalog por edhe me rastin e përdorimit dot e prezantojmë Safety data Sheet dhe licenca për importin e tyre"***

Eksperti shqyrtues pas administrimit te provave, dosjes se tenderit, ankesat e OE qe nga inicimi i aktivitetit te prokurimit, vendimeve te PSH vlerëson se është me rëndësi qe të shpalosen edhe fakti se ky aktivitet i prokurimit është shpallur me 10.06.2022. Nga kjo periudhe ka pas ndryshime ne rregulloret e aplikuara per produktet qe përdoren nga OE-te pjesë e aktivitetit te prokurimit.

AK-ja ju ka drejtuar MMPH me kërkesën për sqarimin për mbi importin e produkteve biocide te cilën zyrtari për produkte biocide e sqaron përmes listës teknike te sigurisë ku janë te specifikuara edhe përqindjet e lejuara për import.

Nga lista shihet se përqindjet kane ndryshuar dhe përmbajtja e lejuar tani është dukshëm me e vogël se me parë.

Duke pas parasysh përmbajtjet e produkteve dhe rrezikshmërinë e tyre për shëndetin publik eksperti shqyrtues e potencon faktin se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit posedojnë licencë për importin e këtyre produkteve si me poshtë:

GOE SV Veterina – NNP WENDA: Safet Osmani BI (SV Veterina) – Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-54/23 i datës 20.01.2023 – **skaduar me 20.07.2023**.

Licenca e MMPHI për import te produkteve biocide me nr 22/226/-1-ZSP e **skaduar me datën 22.04.2023.**

DR Exterminator DDD: licenca e importit nga MMPHI për produkte biocide me nr 22/2940/-1-ZSP **e skaduar me datën:15.06.2023.**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-479/22 **skaduar me 04.05.2023.**

GOE Vlera Shpk – EGIAN MED Shpk: Licenca e MMPHi për produkte biocide me nr 22/5371/-1-ZSP **skadon me datën 27.10.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-516/22 **skaduar me 16.06.2023.**

Flomed Shpk: Licenca e MMPHi me nr 22/6162/-1-ZSP për produkte biocide **skadon me datën 20.09.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-502/22 **skaduar me 25.05.2023.**

Monuni Shpk: Licenca e MMPHi me nr 22/2117/-1-ZSP për produkte biocide **skadon me datën 31.05.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-478/22 **skaduar me 04.05.2023.**

Mburoya Shpk – Vector Pest Control: Licenca e MMPHi me nr 22/2326/-1-ZSP për produkte biocide **skaduar me datën 31.05.2023**

Leja për kryerjen e shërbimeve DDD nga Departamenti i politikave Bujqësorë dhe Tregtisë me nr. 04.5-481/22 **skaduar me 07.04.2023.**

Grup i Operatorëve Ekonomik Samire Osmani; Besim A. Zejnullahu B.I.: Nuk ka dorëzuar licencat

Prandaj duke u bazuar ne faktin se ka kaluar një kohë relativisht e gjatë dhe se OE pjesë të aktivitetit të prokurimit të gjithë posedojnë një apo të gjitha licencat e skaduara dhe sqarimet e zyrtarit te MMPH se përmbajtja e produkteve biocide pjesë e licencës do të ndryshojë në përputhje me rregulloret e reja në fuqi dhe se çdo licencim do të bëhet me rregulla te ndryshuara si dhe çdo plotësim i dokumenteve me rastin e licencimit te serishëm te OE-ve në këtë fazë të aktivitetit te prokurimit do te bëhej ne kundërshtim me nenin **Neni72 Dokumentacionidhe informacionishtesë paragrafi 3 i LPP-se**eksperti shqyrtues vlerëson se AK më të drejtë ka vlerësuar se vjen ne shprehje shëndeti publik dhe se çdo rivlerësim i ofertave ne këtë fazë nuk do të mund të bëhet në përputhje me LPP-në **Neni7 BarazianëTrajtim/Jo-Diskriminimi, Neni59 Ekzaminimi,VlerësimidheKrahasimiiTenderëve, si dhe RRPP 001/2022 Neni 4 Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **S.V.„Veterina**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Burim Zeka